

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.9636, DATË 6.11.2006, “PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, rritjen e monitorimit të duhanpirjes në Republikën e Shqipërisë, sigurimin e mbrojtjes së shëndetit të popullatës nga produktet e duhanit dhe forcimin e rolit monitorues të inspektoratit përgjegjës për shëndetësinë, në lidhje me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e shëndetit nga duhani.

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është në përputhje me objektivat e parashikuar në programin e qeverisë.

Projektligji është i parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim pranë Këshillit të Ministrave, gjatë vitit 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Duhanpirja është një nga faktorët kryesorë të riskut për sëmundjet kronike të cilat janë shkaku kryesor i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë në vend. Prevalenca e duhanpirjes ngelet ende e lartë në vendin tonë dhe është e rëndësishme të reduktohet në mënyrë që të reduktohen edhe sëmundjet kronike.

Ligji për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit ka shërbyer si instrument kyç për kontrollin dhe rregullimin e produkteve të duhanit në vitet e fundit,

duke dhënë rezultate pozitive. Këto rezultate konkretizohen në trendin në rënie të prevalencës së duhanpirjes te meshkujt.

Pavarësisht kësaj, shumë aspekte të duhanpirjes dhe risqeve të lidhura me këtë fenomen ngelen të pambuluara nga ligji në fuqi. Këto aspekte përfshijnë mungesën e kuadrit rregullator për produktet e reja të duhanit që kanë hyrë në treg vitet e fundit, persistimin e promocionit indirekt të produkteve të duhanit pavarësisht se ligji nuk e lejon asnjë formë të promocionit të tyre dhe moszbatimin korrekt të masave ndëshkuese në rast të shkeljeve administrative që lidhen me produktet e duhanit.

Projektligji vjen edhe në zbatim të politikave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit.

Ndryshimet ligjore të propozuara kanë për qëllim të bëjnë rregullimet e mëposhtme:

- Saktësimin e përkufizimeve të duhanit dhe nënprodukteve të tij, si dhe përfshirjen në këtë kategori të produkteve të reja të duhanit. Kjo synon të përfshijë në këtë kuadër rregullator çdo produkt ose nënprodukt duhani që është i dëmshëm për shëndetin e popullatës. Gjithashtu, nëpërmjet këtyre saktësimeve synohet të forcohet kontrolli i duhanit dhe të shmangen rastet abuzive.
- Detyrimin e prodhuesve dhe/ose importuesve të produkteve të duhanit për të informuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për hyrjen në treg të produkteve të reja të duhanit. Nëpërmjet këtij përcaktimi synohet të mbahen të informuara organet përkatëse për dinamikën e hyrjes së produkteve të reja në treg, karakteristikat e tyre dhe për efektet negative që ata kanë në popullatë. Pasja e këtij informacioni pritet të mundësojë monitorim më të mirë të zbatimit të ligjit dhe të përshtatjes së tij në të ardhmen bazuar në produktet e reja që hyjnë në vend.
- Ndalimin e shitjes së paketave me numër të reduktuar cigaresh apo me alterim të shijeve që pritet të reduktojë blerjen e këtyre produkteve nga konsumatorë që nuk e përballojnë dot çmimin e një pakete të plotë apo nga konsumatorë për të cilët shija karakteristike e duhanit është një element i pakënaqshëm i duhanpirjes dhe në mungesë të shijeve alternative do të zgjidhnin të mos konsumonin produktin konvencional.
- Ndalimin e promocionit indirekt nëpërmjet ngjyrave të logos së produkteve të duhanit dhe vendosjen e tyre në rafte të dukshme që bëhet në kuadër të forcimi të kontrollit për moslejimin e promocionit dhe

marketimit të produkteve të duhanit si një faktor që stimulon përdorimin e tij në popullatë.

- Ndalimin e përdorimit të cigares elektronike dhe shishave/nargjileve në ambiente të mbyllura duke aplikuar për të të njëjtat rregulla si për format konvencionale të duhanpirjes, që synon mbrojtjen nga ekspozimi i pavullnetshëm ndaj produkteve të duhanit.
- Forcimin e masave ndëshkuese në rast moszbatimi të ligjit që ka për synim të forcojë implementimin e ligjit dhe shtimin e mbrojtjes për qytetarët që ekspozohen në mënyrë të pavullnetshëm ndaj tymit të duhanit, qoftë nga produkte konvencionale qoftë nga produkte inovative.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji hartohet në mbështetje në nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj përafrohet pjesërisht me direktivën 2014/40/BE, Parlamentit Evropian dhe e Keshillit, e datës 3 prill 2014 “Mbi përafrimin e ligjit, rregullave dhe dispozitat administrative të shteteve anëtare rreth prodhimit, prezantimit dhe shitjes së duhanit dhe produkteve të duhanit dhe shfuqizimi i direktivës 2001/37/KE. Fletorja Zyrtare e Komunitetit Evropian, L 127/1, 29.4.2014, CELEX nr. 32014L0040

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përmban 9 nene.

Ndryshimet dhe shtesat e propozuara në nenin 3 të ligjit në fuqi parashikojnë përkufizime të reja lidhur me produktet e duhanit dhe konkretisht:

- Janë riformuluar 2 përkufizime:

“1. “Produkte duhani” nënkupton produkte që mund të konsumohen dhe përmbajnë, qoftë dhe pjesërisht duhan, të modifikuar gjenetikisht ose jo.”

“7. “Pirje duhani” është ndezja, thithja dhe mbajtja në dorë e ndezur e çdo

produkti duhani si dhe cigares elektronike e shishave/nargjileve.”.

- Pas pikës janë shtuar 18 pikat 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35 e 36, duke shtuar kështu përkufizime të reja për këto produkte:

“19. “Cigare” nënkupton një mbështjellje duhani të grirë e cila konsumohet nëpërmjet procesit të djegies, përveç purove, cigarillove dhe mbështjelljeve të tjera të duhanit.

20. “Duhan kaush/për t’u dredhur” nënkupton duhanin e grirë në fije të imëta që përdoret për pirje pa përpunim të mëtejshëm industrial.

21. “Duhan për llullë” nënkupton duhanin e grirë trashë për pirje me llullë.

22. “Puro” nënkupton duhanin e grirë, të mbështjellë me gjethe duhani ose me mbështjellëse letre me ngjyrë duhani, me ose pa filtër, që konsumohet nëpërmjet procesit të djegies.

23. “Duhan për nargjile (shisha)” nënkupton duhanin i cili konsumohet në formë tymi ose avulli, duke kaluar detyrimisht në një enë uji, i cili mund të jetë ose jo i aromatizuar, ose i përzier me sheqer frutash ose melasë.

24. “Duhan për t’u nuhatur (burnot)” nënkupton një produkt duhani pa tymosje, që konsumohet nëpërmjet nuhatjes.

25. “Duhan për përdorim oral” nënkupton të gjitha produktet e duhanit për përdorim oral, me përjashtim të atyre produkteve që janë për t’u thithur me hundë apo për përtypje, të prodhuara tërësisht ose pjesërisht prej duhanit, në formë pluhuri, grimcash apo të kombinuara së bashku, që paktohen në qeska poroze.

26. “Duhan pa tym” nënkupton një produkt duhani që nuk digjet, duke përfshirë duhanin për përtypje, duhanin për thithje me hundë, duhanin për përdorim oral dhe duhanin me ngrohje.

27. “Tym” nënkupton grimcat e ngurta ose të lëngëta në ajër dhe gazet e krijuara kur një material digjet së bashku me sasinë e ajrit që përthithet apo përzihet me masën, përfshirë edhe tymin e nxjerrë prej mushkërive gjatë duhanpirjes.

28. “Djegje” nënkupton një proces kimik oksidimi që ndodh me një shpejtësi aq të madhe sa të prodhojë nxehtësi dhe zakonisht dritë në formë inkandeshente ose flake.

29. “Produktet e reja të duhanit” nënkuptojnë produktet e duhanit që:

- a) nuk bëjnë pjesë në asnjë nga kategoritë e mëposhtme si: cigare, duhan kaush/për t’u dredhur, duhan për nargjile, puro, cigarillo, duhan për përtypje, duhan për thithje me hundë, duhan për përdorim nga goja;
- b) vendosen në treg pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

30. “Cigare elektronike” nënkupton një produkt që mund të përdoret për konsum të avullit që përmban nikotinë me anë të një pjese që vendoset pranë gojës ose çdo përbërës tjetër i atij produkti, duke përfshirë një mbajtëse, një depozitë dhe një pajisje pa mbajtëse ose depozitë. Cigaret elektronike mund të jenë njëpërdorimshe ose me rimbushje me anë të një ene për rimbushje ose një depozite, ose mund të rikarikohen me një mbajtëse njëpërdorimshe.

31. “Enë rimbushëse” nënkupton një pajisje që mban një lëng me përmbajtje nikotine, e cila mund të përdoret për rimbushje të një cigareje elektronike.

32. “Duhan me ngrohje” nënkupton një produkt duhani, posaçërisht i krijuar për t’u ngrohur që përdoret për të çliruar aerosol që përmban nikotinë dhe substanca të tjera, i cili thithet nga përdoruesit nëpërmjet gojës.

33. “Shije karakteristike” nënkupton një shije apo aromë qartësisht të dallueshme, e ndryshme nga ajo e duhanit, si rezultat i përdorimit të një lënde shtesë apo i një kombinimi lëndësh shtesë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: fruta, erëza, barishte, alkool, karamеле, mentol ose vanilje; të cilat janë të kuptueshme para ose gjatë konsumit të produkteve të duhanit.

34. “Cigarillo” nënkupton një lloj puroje, me peshë jo më të madhe se 3 gram.

35. “Substancë shtesë” nënkupton një substancë të ndryshme nga duhani, e cila i shtohet një produkti duhani, një njësie pakete ose çdo paketimi të jashtëm.

36. “Aromatizues” nënkupton një substancë shtesë e cila mundëson aromë dhe/ose shije.”.

Në nenin 5, të ligjit në fuqi propozohet të shtohen pikat 4, 5, 6, pas pikës 3:

“4. Çdo njësi paketimi e cigareve elektronike dhe paketim i rimbushjeve të lëngut të nikotinës duhet të përmbajë një fletë informuese në gjuhën shqipe

ku të përfshihen informacion rreth: instruksioneve të përdorimit dhe magazinimit të produktit duke përfshirë dhe një referencë që ky produkt nuk rekomandohet të përdoret nga të rinjtë dhe nga joduhanpirësit; kundërrindikacionet e përdorimit; paralajmërimet për grupet e veçanta të riskut, paralajmërimet për efektet anësore; shkallën e varësisë dhe toksicitetit; dhe detajet e kontaktit të prodhuesit ose importuesit.

5. Lëngu me përmbajtje nikotine vendoset në treg vetëm kur është në mbajtje të dedikuara për rimbushje, me volum jo më shumë se 10 ml ose në formën e cigareve elektronike një përdorimshe me volum jo më shumë se 2 ml.

6. Nuk lejohet vendosja në treg e lëngut që përmban më shumë se 20mg/ml nikotinë.”.

Propozohet që në nenin 8 të ligjit në fuqi të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Prodhuesit dhe/ose importuesit e produkteve të reja të duhanit, përfshirë cigaret elektronike dhe duhanin me ngrohje, janë të detyruar të njoftojnë ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë për produktet e reja të duhanit. Ky lajmërim duhet dorëzuar, jo më vonë se 30 ditë para hedhjes në treg të produktit. Njoftimi duhet të përmbajë:

- a) informacion kontakti të prodhuesit ose importuesit në Shqipëri;
- b) një përshkrim i detajuar i produktit;
- c) instruksionet e lidhura me përdorimin e tij;
- ç) listën e përbërësve të produktit;
- d) materialet e disponueshme të kërkimeve shkencore, rrezikun e varësisë dhe tërheqjen e produktit.”.

Është propozuar, gjithashtu, që në nenet 9 dhe 10 të ligjit në fuqi, pas togefjalëshit “produkte të duhanit” të shtohen fjalët “cigareve elektronike, shishave/nargjileve”.

Propozohet që në nenin 11 të ligjit në fuqi, pas fjalisë së parë të shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Ndalohej vendosja në treg e produkteve të duhanit me shije karakteristike. Nuk ndalohej përdorimi i substancave shtesë të cilat janë të domosdoshme për prodhimin e produkteve të duhanit, siç është përdorimi i sheqernave që zëvendësojnë sheqerin e humbur gjatë procesit të përpunimit të duhanit, me kusht që këto substanca shtesë nuk shkaktojnë shije karakteristike dhe nuk rrisin në një nivel domethënës dhe të matshëm shkallën e varësisë, toksicitetit ose karakteristikave karcinogjene, mutagjene dhe toksicitetit për

riprodhim të produktit të duhanit.

Ministria përgjegjëse për shëndetësinë përcakton nëse një produkt duhani konsiderohet produkt duhani me shije karakteristike. Procedurat për mënyrën e përcaktimit të produkteve të duhanit me shije karakteristike bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ndalohet vendosja në treg e produkteve të duhanit që përmbajnë aromatizues në secilin prej komponentëve, si filtra, letra, paketime, kapsula apo çdo modifikim teknik që lejon modifikimin e aromës ose shijes së produktit të duhanit ose intesitetin e tymit. Filtrat, letrat dhe kapsulat nuk duhet të përmbajnë duhan apo nikotinë.

Një njësi pakete cigare duhet të përmbajë të paktën **20** cigare. Një njësi pakete duhan për dredhje duhet të përmbajë jo më pak se 30 gram neto produkt duhani.”.

Gjithashtu janë propozuar ndryshime dhe shtesa edhe në nenet 13 e 20 të ligjit në fuqi e konkretisht:

- Fjalja e fundit e paragrafit të parë të nenit 13 riformulohet, si vijon:

“Ndalohet çdo llojforme tjetër reklamimi i produkteve të duhanit, përfshirë promocionin indirekt përmes ngjyrave që përfaqësojnë logot e kompanive, ose promocionin nëpërmjet ekspozimit të produkteve që imitojnë paketimin e jashtëm të një produkti duhani.”.

- Pas pikës 1 të nenit 20, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Për shkelje të nenit 15 dy herë brenda një periudhe 3-mujore, subjekti i tatueshëm dënohet me gjobë sa dyfishi i gjobës së vendosur në nënndarjen “i”, të shkronjës “ë”, të këtij neni.

Nëse subjekti i tatueshëm i penalizuar për herë të dytë gjendet përsëri në shkelje nenit 15 brenda një afati kohor 1 vjeçar atëherë ndaj tij vendoset gjobë në vlerën gjashtëfishi i gjobës së vendosur në nënndarjen “ii”, të shkronjës “ë”, të këtij neni, dhe pezullim të aktivitetit deri në shlyerjen e masave të gjobës.”.

Ligji ka parashikuar një periudhe 48- mujore të hyrjes në fuqi të tij për paragrafin e parë, të dytë dhe të tretë të nenit 6 të projektligjit, i cili lidhet me ndalimin e vendosjes në treg të produkteve të duhanit me shije karakteristike dhe një periudhë 24-mujore të hyrjes në fuqi që lidhet me paketat që përmbajnë më pak se 20 cigare ose më pak se 30 gram neto produkt duhani. Këto afate janë në përputhje me direktivën 40/2014/BE.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti i Shëndetit Publik dhe Instituti i Sigurimeve Shëndetësore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me grupin e punës i cili kreu një analizë të situatës aktuale nëpërmjet një vlerësimi të zbatimit të tij në të gjitha nivelet, pika të shitjes së produkteve të duhanit, mjedise publike, procesin e inspektimit nga ISSH-ja, nëpërmjet organizimit të vizitave vlerësuese nëpër rrethe, me pjesëmarrje të ekipeve të përbashkëta të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Institutit të Shëndetit Publik dhe Institutit të Sigurimeve Shëndetësore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk parashikon efekte financiare në buxhetin e shtetit, pasi zbatimi i tij do të sigurohet nga strukturat aktuale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet në varësi të saj.

KËSHILLI I MINISTRAVE